

## **KONTRATE DHURIMI E KUOTAVE TE SHOQERISE “VELIPOJA INVESTMENT PROJECT” SH.A.**

Sot me daten 14.04.2022, në Nove Zamky, Slovaki, Ne Feriz MAZREKU dhe Ramadan MAZREKU nënshkruajmë këtë kontratë dhurimi kuotash.

Subjektet e kesaj kontrate me dëshirë të lire dhe me vullnet të pavetësuar kërkojmë të realizojmë kontratën e dhurimit të kuotave të kapitalit themeltare ne shoqerise “VELIPOJA INVESTMENT PROJECT” SH.A, si me poshte vijon:

### **NENI 1 PALA DHURUESE**

Feriz MAZREKU, shtetas i Republikës Slovake, i lindur në Malisheve, Serbi (Kosove), me dt. 04.07.1962, i identifikuar nga Pasaporta me Nr. BE3462862, banues në Nove Zamky, Slovaki, ortakë me 80% të aksioneve të kapitalit të shoqerise, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar,

### **NENI 2 PALA PRANUESE E DHURIMIT**

Ramadan MAZREKU, shtetas i Republikës Kosovës, i lindur në Malisheve, Kosove, me dt. 25.10.1986, i mbajtes i pasaportes me Nr. P01201319, banues në Nove Zamky, Slovaki, ortakë me 20% të kapitalit të shoqerise, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.

### **NENI 3 BAZA LIGJORE**

1. Kjo kontrate hartohet ne baze dhe per zbatim te vullnetit te lire dhe te pavetësuar te paleve percaktuar ne nenin 1 dhe nenin 2 si mesiper.
2. Kjo kontrate hartohet edhe ne baze dhe per zbatim te:
  - a) Kodit Civil te Republikës se Shqiperise dhe ne vecanti nenit 761, nenit 762 te tij;
  - b) Statutin e shoqerise “Velipoja Investment Project” Sh.a.
  - c) Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” dhe ne vecanti neni 105 dhe vijues te tij;
  - d) Vendimit te Asambles se Ortakeve te Shoqerise “Velipoja Investment Project” Sh.a me date 13.04.2022.

### **NENI 4 OBJEKTI**

1. Kjo kontrate ka per objekt dhurimin e 1 (një) kuote qe perben 80 % te vleres se kapitalit themeltar, ekuivalente ne 2 800 Lekë, qe zoteron pala dhuruese Feriz Mazreku ne kapitalin e shoqerise Velipoja Investment Project” Sh.a, qe jane prone e pales dhuruese dhe te te gjitha te drejtave qe lidhen me to.
2. Pala pranuese e dhurimit Ramadan Mazreku, i pranon pales dhuruese Feriz Mazreku, 80 % (tetedhete perqind) te kotave te kapitalit te saj ne shoqerine “Velipoja Investment Project” Sh.a

### **NENI 5**

## DETYRIMET E PALEVE

1. Detyrimet e pales dhuruese:
  - a) Marr persiper dhe deklaroj se jam pronar 80 % te aksioneve ne shoqerin Velipoja Investment Project” Sh.a, dhe ja dhuroj kete 80 %, korresponduese te 1 (nje) kuote, ekuivalente te 2 800 Leke, te kapitalit ne pronesi te Z. Ramadan Mazrekut;
  - b) Garantimet e dhurimit, se keto kuota jane te lire nga cdo barresim dhe detyrim karshi te tereve dhe per cdo pretendim qe mund te ngrene te tretet per cenimin e te drejtese se pronesise se pales pranuese te dhurimit (eviksion), une jam i gateshem dhe i detyruar te paraqitem menjehere me kerkesen e pales pranuese te dhurimit dhe te cdo personi tjeter te tere, qe pretendon mbi keto aksione, para gjithë organeve gjyësore dhe administrative per te mbrojtur te drejten e tij, si pronar i ligjshem i ketyre kuotave pas nenshkrimit te kesaj kontrate.
2. Detyrimet e pales pranuese te dhurimit:
  - a) Pala pranuese ka marre ne dorzim aksionet, duke mos patur asnje verejtje sipas dokumentit ligjor.
3. Detyrimet dy paleshe:
  - a. Palet kontraktuese deklarojne se te gjitha detyrimet e pershkruara me lart dhe te gjitha ato qe burojne nga kjo kontrate dhurimi jane realizuar prej tyre dhe ata nuk kane asnje detyrim te ndersjellte midis tyre.
  - b. Palet kontraktuese deklarojne se aksionet jane marre ne dorëzim nga pala pranuese e dhurimit ne gjendjen egzistuese dhe nuk ka asnje pretendim ne lidhje me kete veprim.

### NENI 6

#### PASOJAT TRANZITORE TE KALIMIT TE AKSIONEVE

1. Pala dhuruese si dhe pala pranuese jane solidarish pergjegjes ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zotërimi i kuotave objek i kesaj kontrate.
2. Pergjegjesia solidarë e pales dhuruese dhe pales pranuese ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zotërimi i kuotave objekt i kesaj kontrate fillon nga casti i kalimit te kuotave nepermjet nenshkrimit te kesaj kontrate dhe perfundon me regjistrimin e ketij kalimi ne perputhje me dispozitat e ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Biznesit” i ndryshuar.

### NENI 7

#### EFEKTET E KONTRATES

1. Kalimi i pronesise se aksioneve nga pala dhuruese tek pala pranuese ne perputhje me percaktimet e kesaj kontrate perfundon me regjistrimin e kesaj kontrate pranë Qendres Kombetare te Regjistrimit dhe ne perputhje me percaktimet e ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Biznesit” i ndryshuar.
2. Kalimi i aksioneve sipas kesaj kontrate regjistrohet ne perputhje me dispozitat e ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Biznesit” i ndryshuar.
3. Regjistrim i percaktuar ne piken 2 te ketij neni ka efekt deklarativ.

### NENI 8

#### DOKUMENTET E BASHKELIDHURA

1. Kesaj kontrate i bashkelidhen dhe konisderohen si pjese e pandashme dokumentet si me poshte vijon:
  - a) Vendimi i Asamblese se Pergjithshme te shoqerise Velipoja Investment Project” Sh.a, date 13.04.2022

b) Dokumenti identifikues i paleve

NENI 9  
DISPOZITA E FUNDIT

1. Keshtu me firmosjen e kesaj kontrate nga palet kontratuese, pala dhuruese Z. Feriz Mazreku zhvishet nga pronesia e 80 % te kapitalit te shoqerise dhe pronar i tyre behet Z. Ramadan Mazreku duke gezuar te gjitha te drejtat ligjore mbi keto kuota ne shoqerine, "Velipoja Investment Project" Sh.a.
2. Palet deklarojne se moren dijeni per kryrjen e regjistrimit te ketij akti midis tyre ne QKB sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi
3. Kontrata mbi kerkesen e paleve u harta ne 2 (dy) kopje.
4. Akti i mesiper eshte ne pajtim te plote me vullnetin e paleve dhe me ligjin dhe nenshkruhet rregullisht nga palet me vullnetin e tyre te lire.

PALET KONTRAKTUESE

PALA DHURUESE

Feriz MAZREKU

Feriz MAZREKU  


PALA PRANUESE

Ramadan MAZREKU

RAMADAN MAZREKU  
